



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.694/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna Drenas/Gllogoc - Drejtoria për Zhvillimin Ekonomik - DZHE, me seli në Gllogoc, rruga “Fehmi dhe Xhevë Lladrovci”, kundër debitorit “Barnatore J-Pharma” SH.P.K., me NUI: 811177791, me seli në Gllogoc, rruga “E Shëndetit”, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.344/23 të datës 26.10.2023 me datën 27.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Barnatore J-Pharma SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.344/23 i datës 26.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar , KPPP.nr.344/23 të datës 26.10.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Barnatore J-Pharma” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.29/23 të datës 07.02.2023, të Përmbaruesit Privat Flamur S. Curri. Ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.29/23 i datës 07.02.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Curri.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse debitori në prapësim ka theksuar se aktvendimi i kreditorit nuk është i plotfuqishëm dhe si rrjedhojë as i ekzekutueshëm dhe vetëm fakti se është organ publik dhe i ka vullat në dispozicion për përdorim nuk nënkupton faktin se debitori e ka pranuar aktvendimin e atakuar. I propozon gjykatës që të pranohet në tërësi si e bazuar ankesa e debitorit, të anulohet aktvendimi i animuar dhe urdhri përmbartimor.

Dhomat e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna Drenas/Glllogoc - Drejtoria për Zhvillimin Ekonomik - DZHE, me seli në Glllogoc, ka paraqitur propozim në bazë të dokumentit përmbartimor Aktvendimit 05 Nr.431/28578 të datës 17.06.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit në emër të kompensimit për taksë komunale shumë prej 1,500.00 €, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor duke theksuar ndër të tjerash se aktvendimin e kreditorit nuk e ka pranuar asnjëherë, ashtuqë konkluzioni i lëshuar nga kreditori se ky aktvendim është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm është i kundërligjshëm, sepse debitori nuk ka nënshkruar asnjëherë aktvendimin në fjalë. Më tutje ka shtuar se që nga data 10.06.2021 e tutje nuk operon si biznes e kjo dëshmohet me pasqyrat financiare nga Administrata Tatimore e Kosovës për të cilën fakt është njoftuar kreditori. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet në tërësi urdhri përmbartimor, si dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit në prapësim për faktin se dokumentet në bazë të cilave është i iniciuar propozimi për përmbarim janë dokumente me të gjitha tiparet e përmbarueshmërisë dhe është i ekzekutueshëm dhe i formës së prerë si dhe i pranuar në kohë nga ana e debitorit. Më tutje ka theksuar se në rastin konkret ka ushtruar veprimtari administrative në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe brenda kufijve të kompetencave. Ka deklaruar se të gjitha bizneset në momentin e pranimit të faturës janë të obliguar që brenda 30 ditëve të bëjnë pagesën e obligimeve, ndërsa në rast që bizneset nuk marrin faturat ato janë të obliguara që vet të interesohen për obligimet e tyre që i kanë ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.344/23 të datës 26.10.2023, me të cilin në dispozitiv të aktvendimit e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit “Barnatore J-Pharma” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.29/23 të datës 07.02.2023, të Përmbaruesit Privat Flamur S. Curri. Ndërsa ka lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr.29/23 i datës 07.02.2023, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Curri.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se Aktvendimi 05 Nr.431/28578 datës 17.06.2022, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, pasi që i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën e përmbushjes së detyrimit”,* dhe se vendimi i kreditorit është dokument përmbarues sipas nenit 22 të LPP-së

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbaruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarimi i propozuar nga kreditori.

Kjo gjykatë vlerëson se Aktvendimi 05 Nr.431/28578, i datës 17.06.2022, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbarimor për të shërbyer si titull përmbarues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbarimor. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Aktvendimi 05 Nr.431/28578, i datës 17.06.2022, është dokument i përmbarueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 03.02.2023, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim.

Dhomat e shkallës së dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri* ”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbarim.

Kjo gjykatë nuk i pranoi si të bazuara pretendimet ankimore të debitorit që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e aktit administrativ në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbarimore, ngase ekzistojnë procedura tjera ligjore për ta kundërshtuar aktin administrativ, ndërsa në këtë rast vendimi i kreditorit, është dokument përmbarues që e parasheh neni 22 par.1 nenp.1.2 të LPP-së, të

Përndryshe, në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.694/24 me datë 27.11.2024

Gjyqtari,

Krenar Berisha